FLETËUDHËZUES I PAKETIMIT:
Informacion për përdoruesin

ALKOOL BORIK

Tretësirë me pika për vesh - 2.5 % - 10 ml
(Acid borik)

Lexojeni me kujdes këtë fletëudhëzues përpara se të filloni përdorimin e barit.

- Ruajeni këtë fletëudhëzues. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është përshkruar për ju. Mos e jepni tek persona të tjerë. Mund t'i dëmtojë ata edhe pse mund të kenë të njëjtat simptoma me ju.
- Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore keqësohet ose në qoftë se vëreni ndonjë efekt tjetër anësor që nuk përmendet në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

Në këtë fletëudhëzues:

1. Çfarë është Alkool borik dhe përse përdoret
2. Përpara se të përdorni Alkool borik
3. Si ta përdorni Alkool borik
4. Efekte anësore të mundshme
5. Si ta ruani Alkool borik
6. Informacion i mëtejshëm

1. ÇFARË ËSHTË ALKOOL BORIK DHE PËRSE PËRDORET

Acidi borik ka veti bakteriostatike dhe fungistatike të dobëta. Tretësira e tij alkoolike (në alkool të holluar) ka efekt analgjezik në otalgjitë. Acidi borik depërton me vështirësi në lëkurën e padëmtuar.
Alkool Borik – tretësirë me pika për vesh përdoret si më poshtë:
Analgjezik dhe antiseptik në otalgjitë.
Mjeku juaj mund ta ketë dhënë Alkool borik për një qëllim tjetër. Pyesni mjekun tuaj në qoftë se doni të dini pse ju është dhënë Alkool borik.

2. PËRPARA SE TË PËRDORNI ALKOOL BORIK

Mos përdorni Alkool borik në qoftë se:

- keni mbindjeshmëri ndaj acidit borik dhe përbërësve të tjerë të përgatesës;
- keni perforacion të timpanit, otit të mesëm kronik, otit të mesëm purulent.

Në qoftë se mendoni se keni ndonjë nga gjendjet e përmendura më sipër, mos i përdorni pikat, shkoni dhe konsultohuni fillimisht me mjekun tuaj dhe ndiqni këshillat e dhëna.

Tregoni kujdes të veçantë me Alkool borik
Për të mënjanuar acarimin e labirintit vestibular, i cili shkakton ndjesinë e marramendjes, këshillohet që tretësira para përdorimit të ngrohet pak, me qëllim që të marrë temperaturën e trupit.

Përdorimi i Alkool borik me ushqim dhe pije
Nuk ka të dhëna për ndikimin e ushqimit dhe pijeve në farmakokinetikën e Alkool borik.

Shtatzënia dhe Ushqyerja me gji.
Nuk ka të dhëna për shfaqjen e efekteve anësore nga përdorimi i Alkool borik gjatë shtatzënisë dhe ushqyerjes me gji.

Drejtimi i automjetit dhe përdorimi i makinerive
Nuk ka të dhëna për shfaqjen e efekteve anësore nga përdorimi i Alkool borik gjatë drejtimit të automjetit dhe përdorimit të makinerive.

Marrja e barnave të tjera
Njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni duke marrë ose keni marrë së fundmi barna të tjera, edhe ato pa recetë.
Këto barna mund të ndikohen nga Alkool borik ose mund të ndikojnë në mënyrën se si ai vepron. Ndaj në përdorimin e njëkohshëm të tyre kemi nevojë të zvogëlojmë ose të shtojmë sasinë e Alkool borik. Mjeku ose farmacisti juaj do t'ju këshillojë.

3. SI TA PËRDORNI ALKOOL BORIK

Gjithmonë përdoreni Alkool borik sipas këshillës së mjekut. Në qoftë se nuk jeni i sigurt kontaktoni me mjekun ose farmacistin. Në qoftë se ndjeni që efektet e Alkool borik janë shumë të forta ose shumë të dobëta, flisni me mjekun ose farmacistin tuaj.
Rekomandohet që pikat e Alkool borik të merren në pozicionin shtrirë në një anë. Në veshin e sëmurë pikohen disa pika tretësirë (2 – 5 pika) dhe në vesh vihet një tampon pambuku. Pas 1 – 2 orësh pikimi i tretësirës mund të përsëritet dhe vazhdohet kështu derisa dhimbja të pushojë. Mjeku juaj mund t'ju kërkojë të merrni Alkool borik për një kohë më të gjatë. Pyesni mjekun tuaj për këshillë në qoftë se nuk jeni të sigurt për kohëzgjatjen e trajtimit.

Në qoftë se keni përdorur më shumë Alkool borik:
Në qoftë se keni përdorur më shumë Alkool borik se sasia që duhet të përdornit, ose në qoftë se fëmijët e kanë marrë gabimisht këtë bar, ju lutemi të kontaktoni mjekun tuaj, spitalin ose të telefononi urgjencën për të marrë një mendim për rrezikun dhe këshillë për veprimet që duhet të ndërmerren.

Në qoftë se keni harruar të përdorni Alkool borik:
Në qoftë se harroni të përdorni një dozë, përdorni dozën pasardhëse kur të jetë koha për përdorimin e zakonshmëm të saj.
Mos përdorni një dozë të dyfishtë për të plotësuar dozën e harruar. Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme mbi përdorimin e këtij produkti, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.

4. EFEKTE ANËSORE TË MUNDSHME TË ALKOOL BORIK

Nuk janë konstatuar efekte të padëshirueshme.
Në qoftë se vëreni efekte anësore që nuk janë të përmendura në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

5. SI TA RUANI ALKOOL BORIK

Mbajeni larg fëmijëve!
Ruajeni në temperaturë më të ulët se 25°C!
Shikoni afatin e përdorimit në paketim përpara përdorimit!
Mbrojeni barin nga drita dhe nga lagështia!

6. INFORMACION I MËTEJSHËM

Çfarë përmban Alkool borik
1 ml tretësirë me pika përmban 25 mg acid borik.
Lënda vepruese është Acid borik.
Përbërësit e tjerë janë ujë i pastruar dhe alkool etilik.

Përmbajtja e paketimit
Forma e paketimit: Kuti kartoni me 1 flakon pikatore 10 ml.

Shpjegues i ikonave ilustruese për paketim:

Mund të merret pa recetën e mjekut.

Përmbajtja. ! Kujdes.

Pika për vesh.

Mbajtësi i autorizimit për tregtim (MAT) dhe prodhuesi:

PROFARMA Sh.a.
Rruga "Myslym Keta"
Tel.Fax: 00 355 4 23 62 800
Tiranë - SHQIPËRI

Ky fletëudhëzues u rishikua për herë të fundit në Shtator 2013.

SPECIFICATION

CROPING AREA 12 x 19 cm

PAY ATENTION, all the layers are visible.
If you have to print this document please check or uncheck the specific layers.